



VENDIM

Nr 26 Date 09.04. 2009

**PER
NDRYSHIMIN E LIÇENSES ME Nr.16, SERIA PV04P, PER
PRODHIMIN E ENERGJISE ELEKTRIKE, LESHUAR SHOQERISE
“WTS ENERGJI” SH.P.K. ME VENDIM TE BORDIT TE
KOMISIONEREVE TE ERE-s, NR. 39, DT. 22.07.2004**

Në mbështetje të neneve 9, dhe 19, të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, neneve 14 dhe 15 të “Rregullores për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plote /te pjesshem dhe rinovimit të licensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr.108, datë 09.09.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 09.04.2009, mbasi shqyrtoi aplikimin e shoqerise “WTS Energji” sh.p.k, për ndryshimin e licenses Nr.16, Seria PV04P, për kryerjen e aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike, leshuar me vendimin e Bordit të Komisionereve nr.39, date 22.07.2004,

Dhe konstatoi se :

-Me vendimin nr.2 date 22.01.2009, Bordi i Komisionereve filloi procedurat për ndryshimin e licenses Nr.16, Seria PV04P, te shoqerise “WTS Energji” sh.p.k, për kryerjen e aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike, leshuar me vendimin e Bordit të Komisionereve nr.39, date 22.07.2004.

-Aplikimi i shoqerise “WTS Energji” sh.p.k, për ndryshimin e licenses Nr.16, Seria PV04P, për kryerjen e aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike, leshuar me vendimin e Bordit të Komisionereve nr.39, date 22.07.2004, është në përputhje me dokumentacionin e kerkuar nga “Rregullorja për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plote /te pjesshem dhe rinovimit të licensave”.

Per gjithë sa me sipër Bordi i Komisionereve



REPUBLIKA E SHQIPERISE
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISE
Bordi i Komisionereve



Vendosi:

1. Ne licensen me Nr.16, Seria PV04P, leshuar me Vendim te Bordit te Komisionereve te ERE-s nr.39, dt.22.07.2004, te behet ndryshimi i fuqise se instaluar te HEC Selce nga 75 kW ne 400 kW.
2. Shoqerise "WTS Energji" shpk ti leshohet licensa me permbajtje te ndryshuar ku reflektohet ndryshimi i mesiperm.
3. Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit te Tregut te njoftojne aplikuesin per Vendimin e Bordit te Komisionereve te ERE

Ky vendim hyn në fuqi menjehere.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Kryetari
Bujar Nepravishta

Ne mungese dhe me porosi
Z. Ardian Haçi



REPUBLIKA E SHQIPERISE
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISE
Bordi i Komisionereve



Votimi i Bordit të Komisionerëve të ERE-s për,

VENDIMIN
Nr. 26 Date 09.04.2009

PER
NDRYSHIMIN E LIÇENSES ME Nr.16, SERIA PV04P, PER
PRODHIMIN E ENERGJISE ELEKTRIKE, LESHUAR SHOQERISE
“WTS ENERGJI” SH.P.K. ME VENDIM TE BORDIT TE
KOMISIONEREVE TE ERE-s, NR. 39, DT. 22.07.2004

Anëtarët e Bordit

	Pro	Kundër
Bujar Nepravishta	_____	_____
Entela Shehaj	_____	_____
Ardian Haçi	_____	_____
Abaz Aliko	_____	_____
Shkelqim Bozgo	_____	_____